UDHËZIM
Nr. 2727, datë 4.2.2020

PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 90/2019, "PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME" DHE PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4, të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme" dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME PËR INDIVIDËT

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi, pasuri të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesë) të regjistruar ose që fitojnë pronësinë dhe e regjistrojnë atë deri në datën 30 shtator 2020, kanë të drejtë që brenda këtij afati të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Këtu përfshihen dhe rastet, kur për pasurinë e paluajtshme është bërë edhe më parë rivlerësimi.

2. Individi mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë ASHK-ja apo një ekspert i vlerësimit të pasurive, i licencuar nga institucionet përkatëse. Për të përfituar nga rivlerësimi, nëpërmjet pasqyrimit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, individi duhet të paguajë më parë tatimin e rivlerësimit (3% e bazës së tatueshme) dhe tarifën e shërbimit, sipas ligjit nr. 90/2019.

3. Në rast se individi ka në pronësi më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën prej këtyre pasurive.

II. LLOGARITJA E BAZËS SË TATUESHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË PËR INDIVIDËT

4. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë ASHK-ja, ai bëhet me çmimet minimale fiskale, që janë në fuqi në momentin e kryerjes së procesit të rivlerësimit dhe në përputhje me përcaktimet e udhëzimit për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme. Në këtë rast, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi (sipas çmimeve minimale fiskale në fuqi) dhe vlerës së zbritshme.

5. Në rast se individi zgjedh rivlerësimin e pasurisë nga një ekspert i licencuar, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerës së zbritshme. Në çdo rast, vlera e pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë nga eksperti i licencuar nuk mund të jetë më e vogël se çmimi minimal fiskal.

6. Vlera e zbritshme, si në rastin e pikës 4 dhe në atë të pikës 5, është vlera e pasurisë sipas së aktit të regjistruar (të fitimit të pronësisë) ose ajo sipas rivlerësimit të mëparshëm (për të cilin është paguar më parë tatimi).

Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë për të përcaktuar vlerën e zbritshme, drejtoria vendore e ASHK-së bazohet në vlerën e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.

6.1 Për zbatimin e këtij udhëzimi, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i kërkon Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe Entit Kombëtar të Banesave listën e çmimeve të kostos mesatare të ndërtimit të banesave, në format digjital *(Excel)*.

III. PARAQITJA DHE ADMINISTRIMI I KËRKESËS PËR RIVLERËSIM NGA INDIVIDËT

A. Aplikimi online

7. Individi ose përfaqësuesi i tij aplikon *online* për shërbimin e rivlerësimit të pasurisë, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania.* Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, ai duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

Aplikimi për shërbimet i drejtohet drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së që është kompetente për territorin ku gjendet pasuria e paluajtshme.

7.1 Individi që aplikon *online* për rivlerësimin e pasurisë duhet të plotësojë në rubrikat përkatëse të platformës *e-Albania,* të dhënat identifikuese të pasurisë që kërkohet të rivlerësohet. Nëse individi nuk plotëson rubrikat që identifikojnë pasurinë, ai duhet, detyrimisht, të ngarkojë në platformë kopje të skanuar të dokumentit të pronësisë që disponon për pasurinë.

7.2 Punonjësi i drejtorisë vendore të ASHK-së shqyrton aplikimin, duke verifikuar:
a) identifikimin e pasurisë sipas përcaktimeve të pikës 7.1; dhe
b) legjitimimin e individit aplikues. Punonjësi verifikon nëse individi që ka paraqitur kërkesën për rivlerësim (ose i përfaqësuari) është pronar apo një nga bashkëpronarët e pasurisë që kërkohet të rivlerësohet.

Nëse nuk përmbushen kushtet e mësipërme, individi njoftohet nëpërmjet platformës, për të identifikuar pasurinë ose për mosvijimin e aplikimit (në rast moslegjitimimi).

7.3 Nëse aplikimi i përmbush kushtet e pikës 7.2, vijohet me llogaritjen e tatimit të rivlerësimit, sipas rregullave të kreut II të këtij udhëzimi, duke hartuar faturën për arkëtim.

7.4 Fatura për arkëtim plotësohet sipas modelit të shtojcës nr. 3 bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Fatura nënshkruhet dhe vuloset elektronikisht nga drejtoria vendore e ASHK-së dhe së bashku me tarifat e shërbimit, i dërgohet aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania.*

7.5 Përjashtimisht, kur individi kërkon
rivlerësimin sipas aktit të ekspertit të licencuar, dërgimi nëpërmjet platformës, i faturës së tatimit të nënshkruar dhe të vulosur elektronikisht, së bashku me tarifën e shërbimit, kryhet vetëm pasi të jetë administruar fizikisht (me postë) akti origjinal i vlerësimit të pasurisë, i nënshkruar dhe i vulosur nga eksperti vlerësues i pasurisë, si dhe fotokopje e njësuar e licencës së tij. Për këtë, individi krahas aplikimit *online,* duhet të dërgojë me postë në zyrën/në drejtorinë vendore të ASHK-së dokumentacionin fizik të mësipërm.

7.6 Pasi të jetë verifikuar shlyerja e pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit, aplikimi i individit konsiderohet i plotësuar dhe ASHK-së i lind detyrimi për të pasqyruar rivlerësimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të këtij udhëzimi.

B. Aplikimi në sportel

8. Përjashtimisht, në rastet kur është e pamundur të administrohet aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania,* aplikimi kryhet pranë zyrës pritëse (sportelit) në drejtorinë/zyrën vendore kompetente, duke paraqitur "Kërkesën për rivlerësim", sipas formularit (shtojca nr. 1) që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, individi duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme, ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

9. Individi apo përfaqësuesi i tij, me prokurë, në çdo rast paraqitet me dokument identifikimi pranë zyrës pritëse ASHK-së. Ai pajiset me dy kopje të paplotësuara të formularit "Kërkesë për rivlerësim" nga punonjësi përgjegjës.

9.1 Individi apo përfaqësuesi i tij, me prokurë, plotëson 2 pikat e para të formularit. Të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentacionin bashkëlidhur (kopje të dokumentit të pronësisë) verifikohen sipas përcaktimeve të pikës 7.2 të këtij udhëzimi.

9.2 Në rast përputhjeje të të dhënave, punonjësi përgjegjës plotëson pikën 3 të formularit me vlerën e zbritshme (vlera e pasurisë, sipas aktit të regjistrimit, ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar më parë tatimi).

9.3 Punonjësi llogarit tatimin që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, sipas kreut II të këtij udhëzimi, duke plotësuar pikën 4 të formularit "Kërkesë për rivlerësim".

9.4 Pas plotësimit të të gjithë pikave të mësipërme të formularit "Kërkesë për rivlerësim", punonjësi përgjegjës e nënshkruan atë dhe një kopje ia jep individit ose përfaqësuesit të tij. Individi ose përfaqësuesi i tij pajiset, gjithashtu, me faturën për arkëtim (shtojca nr. 3) për pagesën e tatimit, si dhe për tarifat e shërbimit.

9.5 Individi, pasi paguan në bankë tatimin dhe tarifën e shërbimit, dorëzon vërtetimin e pagesës së tyre pranë drejtorisë vendore të ASHK-së. Vërtetimi i pagesës i bashkëlidhet formularit të aplikimit.

9.6 Pas kryerjes së pagesës së tatimit dhe tarifave të shërbimit, aplikimi konsiderohet i plotësuar dhe drejtorisë vendore i lind detyrimi për të pasqyruar rivlerësimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të këtij udhëzimi.

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PASQYRIMIN E RIVLERËSIMIT TË PASURISË NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME

10. Në zbatim të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", drejtoria vendore e ASHK-së, brenda 5 ditëve nga verifikimi i pagesës së tatimit të rivlerësimit të pasurisë dhe tarifave të shërbimit, duhet të kryejë shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për pasqyrimin e rivlerësimit, nëpërmjet punonjësit të ngarkuar me këtë detyrë. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit.

11. Punonjësi i ASHK-së kryen shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, bazuar në dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas rasteve të parashikuara me poshtë:

11.1 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, pasqyrimi i rivlerësimit të pasurisë kryhet në seksionin "D" të kartelës së pasurisë.

Në këtë seksion do të regjistrohet data e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shuma e rivlerësimit, referenca arkivore përkatëse, si dhe afati i vlefshmërisë së këtij regjistrimi. Për afatin e vlefshmërisë vendoset shënimi: "Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë, në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 30.7.2018".

Me kryerjen e një transaksioni të ri për tjetërsimin e pasurisë (përveç trashëgimisë), pasuria merr vlerën sipas aktit të ri të kalimit të pronësisë.

11.2 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, pasqyrimi i rivlerësimit kryhet në rubrikën/kolonën "Shënime transkriptimi" të regjistrit hipotekar, duke përcaktuar datën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shumën e rivlerësimit, referencën arkivore përkatëse, si dhe afatin e vlefshmërisë se këtij regjistrimi. Për afatin e vlefshmërisë vendoset shënimi: "Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë, në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 30.07.2018". Me kryerjen e një transaksioni të ri për tjetërsimin pasurisë (përveç trashëgimisë), pasuria merr vlerën sipas aktit të ri të kalimit të pronësisë.

11.3 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, gjendet në një zonë kadastrale që është duke iu nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, procedohet me regjistrimin e këtij të fundit në regjistrin përkatës hipotekar apo në kartelat provizore, duke pasqyruar datën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shumën përkatëse të rivlerësimit, referencën arkivore, si dhe shënimin për afatin e vlefshmërisë së regjistrimit të rivlerësimit, njësoj si në dispozitat e mësipërme (11.1 dhe 11.2).

Në përfundim të procesit të regjistrimit fillestar, shënimet e mësipërme të rivlerësimit pasqyrohen në kartelat e pasurive të paluajtshme, produkt i këtij procesi.

V. RIVLERËSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURI- DIKË

12. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2019, në zërin aktive afatgjata materiale, pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga vlerësues të pasurisë, ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

13. Përfaqësuesi i personit juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku personi juridik është i regjistruar, dokumentet e mëposhtme:

a) deklarimin vullnetar për rivlerësimin e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
b) prokurën për përfaqësuesin ligjor, nëse kjo procedurë kryhet nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij;
c) kopje të licencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurisë;
d) kopje të faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurisë;
e) aktin origjinal të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe të vulosur nga vlerësuesi i pasurisë;
f) pasqyrën financiare (bilancin kontabël) të vitit 2019, ku rezulton e regjistruar në zërin aktive afatgjata materiale, pasuria e paluajtshme që rivlerësohet, përfshirë anekset shpjeguese për aktivin afatgjatë material që rivlerësohet;
g) kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë, në masën 5% të diferencës, ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në pasqyrat financiare. Pagesa kryhet në njërën nga bankat e nivelit të dytë për llogari të thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr. 4.

Personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivit dhe tatimin përkatës, të paguar sipas legjislacionit në fuqi.

13.1 Data e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet data e pagesës së kryer, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme".

13.2 Diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit përkatës të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare, regjistrohet përkatësisht në zërin përkatës të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Kjo vlerë nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

13.3 Pasqyrave financiare për rivlerësimet që kryhen brenda periudhës gjatë së cilës i shtrin efektet ligji, sipas nenit 5 të tij, u bashkëlidhen pasqyrat analitike të vlerës kontabël të pasurive të paluajtshme të rivlerësuara.

VI. PAGESA E TË ARDHURAVE NGA TATIMI I RIVLERËSIMIT NË BUXHE- TIN E SHTETIT

14. Pagesa e tatimit nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme kryhet pranë bankave të nivelit të dytë, sipas modeleve të formularit të faturës për arkëtim, përkatësisht, për individët (shtojca nr. 3) ose për personat juridikë (shtojca nr. 4), që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

15. Klientëve-individë u vihet në dispozicion formulari i faturës nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së.

16. Klientëve-persona juridikë, u vendoset në dispozicion formulari nga degët përkatëse të bankave. Gjithashtu, ky formular mund të shkarkohet edhe elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

17. Për personin juridik është e detyrueshme që, përveç të dhënave të nënshkruesit, në faturën për arkëtim të plotësohen, gjithashtu, emri i personit juridik (shoqërisë) dhe NIPT/NUIS. Pas verifikimit për plotësimin e të dhënave të plota, banka në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pranon të kryejë arkëtimin, duke evidentuar llojin e të ardhurës, si dhe kodin e institucionit sikurse është përcaktuar në "Faturën për arkëtim", në bazë të kodit të të cilave do të kryhet kontabilizimi në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).

18. Tatimi mbi të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme (3%), që paguhet nga individi, arkëtohet në një llogari të veçantë të hapur nga çdo drejtori vendore e ASHK-së pranë bankave të nivelit të dytë. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, vlera e tatimit kalohet në llogarinë e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në buxhetin e shtetit, në drejtoritë tatimore përkatëse.

Brenda së njëjtës datë (të çdo muaji pasardhës), drejtoritë vendore të ASHK-së dërgojnë në drejtoritë tatimore përkatëse evidencën manuale dhe/ose elektronike, me të dhënat e individit që ka kryer rivlerësimin e pasurisë, si dhe shumën e tatimit të llogaritur nga rivlerësimi.

19. Llogaritja dhe arkëtimi i tatimit 5% për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të personave juridikë bëhet nga drejtoritë rajonale tatimore përkatëse. Ky tatim llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të pasurisë të regjistruar në pasqyrat financiare të vitit 2019. Kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020400, për llogari të buxhetit të shtetit.

Banka transferon arkëtimet në llogaritë bankare përkatëse në emër të degës së thesarit të çdo rrethi për çdo drejtori rajonale tatimore, sipas kodeve përkatëse të çdo drejtorie.

Drejtoritë rajonale tatimore, çdo muaj, bëjnë rakordimin me degën e thesarit për arkëtimet e kryera, në përputhje me këtë udhëzim.

20. Në raste të derdhjeve gabim të tatimit të rivlerësimit për individët dhe detyrimit për të kthyer tërësisht ose pjesërisht shumën, drejtoritë vendore të ASHK-së hartojnë dokumentacionin justifikues për kthimin e shumës tek individi, pas kërkesës së individit.

Në rast se individi paraqet kërkesën për kthim shume, brenda datës 10 të muajit pasardhës, drejtoria vendore e ASHK-së bën drejtpërdrejt kthimin e shumës të arkëtuar gabim. Nëse është tejkaluar ky afat dhe të ardhurat kanë kaluar në buxhetin e shtetit, kërkesën, individi duhet ta paraqesë për kthimin e shumës së mbajtur gabim pranë drejtorisë tatimore përkatëse. Në funksion të kthimit të shumës së mbajtur gabim, drejtoria vendore e ASHK-së dërgon dokumentacionin justifikues provues pranë drejtorisë tatimore përkatëse, e cila pas administrimit të dokumentacionit kthen shumën e mbajtur gabim tek individi.

VII. TARIFA E SHËRBIMIT DHE DISPOZITA TË FUNDIT

21. Tarifa për shërbimin e rivlerësimit për individët, pranë ASHK-së, është 1200 (një mijë e dyqind) lekë.

22. Pas kryerjes së rivlerësimit për individët, sipas këtij udhëzimi, në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të rivlerësuar, në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi. Nëse kjo diferencë është negative, individi nuk paguan tatim.

23. Aplikimet për rivlerësim të pasurive të cilat paraqiten pranë ASHK-së, brenda 30 shtatorit 2020, por nuk janë përfunduar, procedohen edhe pas kësaj date, nëse tatimi i rivlerësimit është paguar brenda datës së mësipërme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare[1].

MINISTRI I EKONOMISË DHE FINANCAVE
Anila Denaj

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ASHK-së
Artan Lame

[1] Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.13, datë 05.02.2020

SHTOJCA NR. 1

FORMULAR "KËRKESË PËR RIVLERËSIM" (PËR INDIVIDËT)

Drejtuar: drejtorisë/zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

_____

1. Të dhënat e aplikuesit

Emri/atësia/mbiemri i aplikuesit:_____

Numri i identifikimit në kartën e identitetit _____, lëshuar nga _____

Data e lëshimit:_____

Adresa e banimit_____, adresa e dytë(nëse ka)_____

2. Të dhënat e pasurisë së paluajtshme

Në përputhje me ligjin nr. 90/, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", aplikoj për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

Lloji i pasurisë së paluajtshme (tokë/ndërtesë)

Numri i regjistrimit në zyrën kadastrale_____, sipërfaqja në m^2 (me shifra dhe me fjalë)

m^2_____

Data e regjistrimit në ASHK:_____

Çmimi i blerjes së pasurisë, bazuar në kontratën e shitblerjes/vlera e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi _____

_____

(me shifra dhe me fjale për t'u plotësuar nga ASHK-ja)

3. Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme

3.1 Në rast se kryhet nga ASHK-ja

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas çmimeve minimale fiskale në fuqi

_____

(në shifra dhe me fjalë)

3.2 Në rast se kryhet nga eksperti i pasurisë

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas aktit të ekspertimit

_____

(me shifra dhe me fjalë)

4. Tatimi për t'u paguar

4.1 Baza e tatueshme = (vlera e dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi minus vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar apo vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

_____

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

4.2 Baza e tatueshme = (vlera e tregut të pasurisë së pasqyruar në akt ekspertimi (jo më e vogël se çmimi minimal fiskal) minus vlerën e pasurisë, sipas aktit të regjistruar apo të vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

_____

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit:_____

Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ASHK-ja:

_____

SHTOJCA NR. 2

DEKLARIMI VULLNETAR PËR RIVLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Tatimeve:_____

Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Unë z./znj._____, përfaqësuesi i personit juridik_____,
me NIPT/NUIS_____ , me adresë _____, pajisur me autorizim për përfaqësim_____, deklaroj se në bazë të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", deklaroj vullnetin tim për të kryer rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në pasqyrën financiare (bilanci kontabël) të periudhës_____.

Baza e tatueshme = (diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit të ekspertit dhe të vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare (në shifra dhe fjalë)

_____

Pagesa = 5% x bazën e tatueshme_____

Emri/mbiemri: _____
(nënshkrimi)

Data: _____

SHTOJCA NR. 3

FATURË PËR ARKËTIM
Nr._____, datë_____

Bankës_____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____
Emri institucionit: Drejtoria Vendore e ASHK-së_____
Numri i llogarisë dhe IBAN për RVP: _____
Kodi i degës së thesarit:

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Mënyra e përllogaritjes	Shuma që arkëtohet (lekë)	Nr. i llogarisë së DVASHK-së për RVP-në
1	Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga ASHK-ja	3% (e vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale – (minus) vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar/të rivlerësuar)		
2	Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga eksperti vlerësues i licencuar	3% (e vlerës së dalë nga akti i ekspertimit, jo më pak se çmimet minimale fiskale – (minus) vlerën e pasurisë sipas aktit të regjistruar, /të rivlerësuar)		

DREJTORIA VENDORE ASHK
Emër/mbiemër/firmë

_____

KLIENTI
Individ_____
Emër/mbiemër

SHTOJCA NR. 4

FATURË PËR
ARKËTIM
Nr._____, datë_____

Bankës_____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (persona juridike/individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është _____
Emri institucionit përfitues (teknik): Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme
Kodi i institucionit përfitues: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi_____ Kodi i degës së thesarit: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi_____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	Shuma që arkëtohet (lekë)
1	... tatim nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%)		

DREJTORIA TATIMORE
Emër/mbiemër/firmë

_____

KLIENTI
Person juridik_____ NIPT/NUIS: _____

Administratori/Përfaqësuesi

_____

Emër/Mbiemër/Nënshkrimi

_____

Adresa:
Kontakti: